



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr. 384/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Enver Gashit kryetar i degës të subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Obiliq, paraqitur kundër kryesuesit të vendvotimit 1505E/02D për shkak të gabimeve teknike gjatë procesimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017 në seancën e panelit të mbajtur me 24.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa ZL A.nr 378/2017 e datës 23.10.2017, e parashtruar nga Enver Gashi kryetar i degës të subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Obiliq, paraqitur kundër kryesuesit të vendvotimit 1505E/02D, për shkak të gabimeve teknike gjatë procesimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 23.10.2014, nga Enver Gashi kryetar i degës të subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Obiliq në të cilën pretendon se kryesuesi i vendvotimit 1505E/02D nga radhët e AAK-së, gjatë procedimit të votave për kandidatet e AAK-së ka bërë gabim me votat e tyre. I njëjti kërkon që votat për kandidat te AAK-së të dalin në FRP dhe në rezultatet përfundimtare.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë përkitazi me gabimet gjatë numërimit të votave në vendvotimin 1505E/02D për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatit të votimit, nga shkelësi i supozuar, duhet të parashtrohen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të

procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së ankuesit Enver Gashi, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesit nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL Anr. 384/2017 më datën 24.10.2017

Kryesuesi i Panelit
Zyhë Haxhiri



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.